



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1407/004

Dt 10.10.2017

Në bazë të nenit 48 pika 1.3, nenit 154 dhe nenit 156 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2017, mori:

VENDIM

- 1. Dr. sc. Ismet Mulliqi** zgjidhet **profesor i asocuar** për lëndët: Mekanika e fluideve; Bartja e nxehtësisë dhe masës; dhe Termodinamikë inxhinierike, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore.
1. Zgjedhja e të përmendurit është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 156 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
2. I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
3. Zgjedhja zgjat për periudhën 4 (katër) vjeçare.
4. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
5. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet nga data 3.10.2017, pas deklarimit për pagë primare në UMIB.

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi lëndët: Mekanika e fluideve; Bartja e nxehtësisë dhe masës; dhe Termodinamikë inxhinierike, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore.

Këshilli i Fakultetit e ka shqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që dr. sc. Ismet Mulliqi të zgjidhet profesor i asocuar për lëndët e sipërpërmendura. **Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për Studime, vendosi që dr. sc. Ismet Mulliqi të zgjidhet profesor i asocuar për lëndët: Mekanika e fluideve; Bartja e nxehtësisë dhe masës; dhe Termodinamikë inxhinierike, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore.**

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit për paga;



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Alush Musaj
Rektor i UMIB-it